



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

Nr. 284/Prot/ (D.P)

Tiranë, më 21.04.2021

Lënda: Dërgojmë vendimin për mosfillimin e procedimit penal.

Drejtuar: PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË


TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njoftim vendimin për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal të bërë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr.51prot, datë 07.04.2021.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ARBEN KRAJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

V E N D I M

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL

Në Tiranë, sot në datën 21.04.2021, unë Dritan Prençi, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pasi studiova aktet e kallëzimit penal nr. 106, datë 13.04.2021,

K O N S T A T O V A:

Se në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me datë 09.04.2021 është regjistruar kallëzimi penal i subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, ndaj shtetasit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, “Kansojes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a dhe 329 të Kodit Penal.

Rrethanat e faktit të kallëzuar.

Në përmbajtje të kallëzimit përshkruhet se në datë 25 Prill do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe prej disa kohësh ka filluar organizimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore. Në këtë kuadër, të paktën 4 muajtë e fundit është vënë re shtim në masë i veprimeve të kundraligjshme nga ana e qeverisë, si dhe vetë [REDAKTUAR] në funksion të ndikimit tek vullneti i qytetarëve dhe për pasojë ndryshimit me çdo mjet dhe mënyrë të paligjshme të rezultatit të zgjedhjeve në favor të Partisë Socialiste.

Në kallëzim pretendohet se në datën 06.04.2021, në një bisedë gjatë rrugës Leskovik - Përmet me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] ka kërcënuar dhe shantazhuar drejtpërsëdrejti mësuesit dhe infermierët që të mbrojnë pozicionet e tyre të punës vetëm duke votuar Partinë Socialiste.

Në bisedën e transmetuar live në facebook dhe mediat e vendit, [REDAKTUAR] u shpreh konkretisht:

[REDAKTUAR]: “Isha në Krujë dhe situatë duket shumë mirë, ka shumë entuziazëm, sidomos tek të rinjtë që kanë hyrë në punë përmes portaleve tona “Mësues për Shqipërinë” dhe “Infermier për Shqipërinë”.

[REDAKTUAR]: “Duhet ta mbrojnë pozicionin e tyre me votë, në drejtim të paditur përfundon në drejtim të paditurçdo gjë, edhe puna e tyre se e fillojnë prapë ata se nuk dinë gjë tjetër”.

Në kallëzim pretendohet se me këtë deklaratë, Kryeministri, jo vetëm që ka shkelur legjislacionin në fushën e zgjedhjeve, por ka konsumuar edhe vepra të rënda penale, si *shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv në zgjedhje, përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore dhe kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje*.

Kallëzusi pretendon se në rastin konkret, [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryeministrit të vendit, ju siguron pozicionin e punës punonjësve të administratës vetëm nëse votojnë Partinë Socialiste. Nëpërmjet kësaj deklarate të bërë publikisht nga vetë [REDAKTUAR], me qëllim maksimizimin e votës për Partinë Socialiste, janë konsumuar të gjitha elementët e veprës penale të "*Korrupsionit aktiv në zgjedhje*", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Në rrethanat e mësipërme, kallëzuesi pretendon se në rastin konkret, përdorimi i administratës, vendeve të punës dhe pasurive publike nga [REDAKTUAR] në cilësinë e Kryeministrit, bëhet vetëm me qëllim favorizimin e Partinë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit. Sipas kallëzuesit, janë konsumuar edhe elementët e veprës penale të "*Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore*", parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

Kallëzuesi pretendon se në rastin konkret, me deklaratën publike dhe shprehjen e përdorur nga [REDAKTUAR] "*Duhet ta mbrojnë pozicionin e tyre me votë*", është e qartë kanosja dhe kërcënimi i administratës publike me vendin e punës në rast se nuk votojnë për Partinë Socialiste. Pra, janë plotësuar edhe elementët e veprës penale të "*Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje*", parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal.

Gjithashtu, në përmbajtje të kallëzimit përshkruhet se në administratën publike tashmë punojnë 185 mijë persona, nga 85 mijë të punësuar në vitin 2013. Nga të cilët, 10 mijë persona janë punësuar vetëm gjatë muajve të fundit për qëllime elektorale. Pa përfshirë këtu edhe 2.500 punonjës të punësuar me kontrata të përkohëshme nëpërmjet VKM nr. 1151, datë 24.12.2020 "*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme, për vitin 2021, në Njësitë e Qeverisjes Oendrore*".

Në vijim të kallëzimit pretendohet se me këtë kërcënim të drejtpërdrejtë, Kryeministri ju drejtohet 185 mijë punonjësve të administratës publike dhe familjarëve të tyre që të votojnë Partinë Socialiste, në të kundër do të largohen nga puna.

Gjithashtu, pretendohet se me këtë veprim, vetë Kryeministri jo vetëm që ka cënuar zgjedhjet e lira dhe të ndershme, por mbi të gjitha ka konsumuar një sërë veprash të rënda penale, pasojat e së cilave ndikojnë drejtpërsëdrejti në rezultatin e zgjedhjeve.

Sipas kallëzuesit, në rastin konkret, në cilësinë e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] ka shpërdoruar detyrën nëpërmjet deklaratës kërcënuese ndaj mësuesve dhe infermierëve që të mbrojnë pozicionin e tyre me votë. Si kreu i qeverisë, ai duhet të marrë të gjitha masat për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme, ndërkohë që me veprime kërcënuese dhe shantazhuese, në kundërshtim me ligjin dhe në shpërdorim të detyrës, shndërohet në shkelësin kryesor të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal, duke sjellë pasojat të rënda në zgjedhjet e 25 Prillit.

Në lidhje me verifikimin e këtij kallëzimi, nga ana e policisë gjyqësore, me datë 16.04.2021, është bërë këqyrje e faqes së kërkuar në internet, në adresën <https://facebook.com.edirama.al/>. Nga këqyrja ka rezultuar se me datë 06.04.2021, [REDAKTUAR] ka postuar me datë 06.04.2021, ora 11:12 AM, një video të titulluar "Mes pyjeve për Përmet me Milvën për Durrësin". Kjo video ka rezultuar se është 5 minuta e 33 sekonda dhe ka adresë: <https://www.facebook.com/edirama.al/videos/362256915066497/>.

Në këtë video, [REDAKTUAR] ka zhvilluar një bisedë prej 1 minutë e 30 sekonda me deputeten [REDAKTUAR] me përmbajtje bisede:

[REDAKTUAR]: Aloo... [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR] si jeeee? [REDAKTUAR]: "Mirëmbërëma, si jeni [REDAKTUAR] "Unë mirë jam, po ec nëpër pyje në një rrugë Leskovik-Përmet, se do shkoj në Përmet, një natyrë fantasike këndeje, po tani ka rënë errësira dhe nuk duket asgjë, kështu thashë të bëj ca telefona, si duket situata andej në Durrësin tim të dashur? [REDAKTUAR]: "Unë jam aktualisht në Krujë, isha në Krujë sot dhe në Anameras, dje isha në Durrës. Në fakt duket shumë mirë, ka shumë entuziazëm, sidomos tek kjo pjesa e të rinjve që kanë hyrë nëpër punëra nëpërmjet meritokracisë me portalet tona, me portalin "Mësues për Shqipërinë" dhe "Infermier për Shqipërinë", janë super entuziast, super entuziast" [REDAKTUAR]: "Tani, mësuesit për Shqipërinë dhe infermierët për Shqipërinë kanë hyrë me meritën e tyre, por çështja është që duhet ta mbrojnë pozicionin e tyre se me votën në drejtim të paditur përfundon në drejtim të paditur çdo gjë këtu në këtë vend, plus edhe puna e tyre, se fillojnë prapë nga e para ata, se nuk dinë ata gjë tjetër, e ke parasysh". [REDAKTUAR]: "Edhe ata vetë e kishin parasysh shumë mirë këtë gjë, se kishin vujt gjatë për ta fitu vendin, edhe pse kishin dalë mirë me rezultate..."

Nga aktet e administruara, në lidhje me pretendimet e parashtruara në kallëzim nuk evidentohet asnjë indicie, fakt apo provë që mund të përbëjë dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementëve të veprave penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Korrupsionit aktiv në zgjedhje", "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", "Kansojes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a dhe 329 të Kodit Penal.

Arsyetimi ligjor.

Nga aktet e administruara rezulton se, me dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 11700, datë 06 Shtator 2020 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin", është caktuar data 25 Prill 2021, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të zhvillimit të një procesi zgjedhor të ndershëm dhe transparent, Komisioni Rregullator pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, ka miratuar dhe vendimin Nr. 9, datë 24 Dhjetor 2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Qëllimi i këtij vendimi është vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare e logjistike të institucioneve qëndrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore gjatë periudhës kohore katër muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.

Bazuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, parashikohet "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të

Sipas nenit 3 të këtij vendimi *“Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar, janë veprimtaritë publike sipas nenit 2/b, të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, në periudhën katër mujore para zgjedhjeve dhe që përfshijnë....*

Në pikën 1/3 të nenit 1, gërma “d” të kësaj dispozite, parashikohen rastet si *“veprimtari të ndaluara”*: *“gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”*.

Në analizë të fakteve dhe provave të sipërcituara, organi procedues çmon se në rastin konkret nuk ndodhemi para elementëve të veprës penale të *“Shpërdorimit të detyrës” “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” apo “Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a dhe 329 të Kodit Penal.*

Sipas dispozitës së nenit 248 të Kodi Penal, *“Shpërdorimi i detyrës”, parashikohet: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, ku i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridike, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet”*.

Sa më sipër, organi procedues çmon se në veprimet e [REDAKTUAR] nuk vërehen veprime të kundërligjshme, që të konsistojnë në mospërmbushje të rregullt të detyrës.

Sipas dispozitës së nenit 328 të Kodit Penal, *“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kjo vepër penale nga ana objektive kryhet në formën e ofrimit ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike.*

Organi procedues çmon se në rastin e kallëzuar, nuk ka rezultuar që të jetë kryer ndonjë nga format e mësipërme, si element i figurës së veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje.

Sipas nenit 328/a të Kodit Penal, *“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikohet:*

“Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në aktivitetet ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. 3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë. 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. 5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike".

Sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, ndalohet rekrutimi në punë apo largimi nga detyra, apo dhe transferimi i nëpunësve me përjashtim të rasteve të përligjura, kur lirimi bëhet për shkaqe ligjore, apo kur marrja në punë bëhet për një vend pune i cili ka qëndruar vakant para fushatës. Po kështu ndalohet katër muaj para zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re, propozimi apo miratimi i akteve ligjore e nënligjore që prekin në aspektin social një masë të madhe të popullsisë, pra të zgjedhësve dhe që lidhen me rritjen e pagave, pensioneve, ndihmës ekonomike, uljen e taksave etj.

Nga përmbajtja e vendimit Nr.9, datë 24 Dhjetor 2020, i Komisionit Rregullator të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, qëllimi i këtij rregullimi nënligjor, ka qenë përcaktimi i veprimtarive të ndaluara, synimi i parandalimit të veprimtarive të ndaluara nëpërmjet përdorimit të gabuar, të burimeve njerëzore, financiare e logjistike gjatë periudhës kohore para zgjedhjeve, me synim krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët apo partive politike, si dhe përcaktimi i rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qëndrore dhe vendore, agjencive dhe enteve shtetërore etj.

Veprimtari publike sipas nenit 2/b të këtij vendimi janë "të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për publikun dhe të medias, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë agjendë informimin për periudhën katër mujore para datës të zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve".

Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Organi procedues çmon se fakti nuk përmban as elementët e figurës së veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

Sipas dispozitës së nenit 329 të Kodit Penal, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikohet:

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Organi procedues çmon se nga aktet e administruara nuk rezultojnë rrethana fakti as për veprën penale të “Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal.

Në këto rrethana, organi procedues çmon se nuk janë konsumuar elementët e figurave të veprave penale të pretenduar nga kallëzuesi, as elementët e ndonjë figure vepre penale tjetër, fakti në tërësinë e tij nuk përbën vepër penale dhe për rrjedhojë, procedimi penal nuk mund të fillojë.

Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, “Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit”, parashikon:

“Procedimi penal nuk mund të fillojë kur... pika 1, gërma “ç”, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë se fakti nuk ekziston..”.

Sa më sipër, procedimi penal nuk mund të fillojë, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, pika 1, parashikon:

“Kur ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”.

Për këto arsye, në mbështetje të neni 290 pika 1, gërma, “ç” dhe neni 291 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSA :

1. Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr.106, datë 13.04.2021.
2. Vendimi t’u njoftohet të interesuarve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI

DRITAN. PRENÇI

